



Pranimar / Dorezuar Prilijeno/Protdate Received/Delivety	22.02.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr. Prot Pr. No	Shloja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SJK	1997/2023		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

A.nr.36/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.36/2023, të datës 10.01.2023, të ankuesit _____, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.02.2023 mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.36/2023 e datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ sipas shkresave të lëndës i punësuar në pozitën Zëvendës Kryeinspektor në Inspektoratin e Punës, ka parashtruar ankesë me datë 10.01.2023, e cila është regjistruar nënë shenjën 123/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 2317 të datës 08.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e refuzimit të kërkesës së tij të datës 25.08.2022 lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 45 të Ligjit për Zyrtarët Publik pasi që nëpunësi civil ndaj të

cilit ishte iniciuara procedura disiplinore ka kryer shkelje të detyrave të punës me rastin e dërgimit të e-mailit të datës 08.05.2022 tek ankuesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Inspektorati i Punës. Ndërsa me datë 10.01.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 36/2023, e datës 10.01.2023, me numër protokoll 123/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.12.2022, me numër protokoll 2317, i Komisionit Disiplinor; Kërkesës e datës 28.05.2022, për iniciimin e procedurës disiplinore për [] ; E-maili i datës 08.05.2022; Vendimi i datës 16.02.2022, me numër protokoll 54/2022, i shkallës së dytë kundër vendimit e numër protokoll 02, Nr. 22-77/2021 B, lidhur me ankesën e [] ; Vendimi i datës 09.02.2022, me numër protokoll 29/20221, i shkallës së dytë kundër vendimit e numër protokoll 01, Nr. 40-71/18/ B, lidhur me ankesën e [] dhe [] ; Vendimi i datës 28.03.2022, me numër protokoll 171/2022, i shkallës së dytë kundër vendimit e numër protokoll 02, Nr. 17-98/2021 B, lidhur me ankesën e [] Vendimi i datës 10.02.2022, me numër protokoll 133, i shkallës së dytë kundër [] me të cilin ka refuzuar ankesën e Spitalit Sheikh Zayed; Vendimi i datës 04.03.2022, me numër protokoll 107/2022, i shkallës së dytë kundër vendimit e numër protokoll 02, Nr. 22-69/2021 B, lidhur me ankesën e [] ; e- maili i datës 17.05.2022; e- maili i datës 08.07.2022; Procesverbali i datës 06.12.2022, me numër protokoll 2293 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 06.12.2022, me numër protokoll 2292 i Komisionit Disiplinor; e- maili i datës 24.11.2022; Përshkrimi i detyrave të Punës i [] ; Akt Emërimi i datës 07.02.202, i [] ; Përgjigje në ankese e datës 25.01.2023, me numër protokoll 812/2023;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesi [] është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Zëvendës Kryeinspektori i Punës për Siguri në Punë, me datë 25.08.2022 përmes Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, ka bërë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor ndaj nëpunësit civil [] i cili mban pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Inspektoratit të Punës në Regjionin e Mitrovicës" me arsyetimin se i njëjti me rastin e dërgimit të e-mailit të datës 08.05.2022, përmes të cilit ka kërkuar nga Zëvendës Kryeinspektori i Punës për Siguri në Punë për të bërë verifikim mos rastësisht dikush në Inspektoratin e Punës është duke i vonuar lëndët të cilat trajtohen në Komisionin e shkallës së dytë.

Komisioni Disiplinor i Inspektoratit të Punës me datë 08.12.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll:2317 përmes të cilit e ka refuzuar kërkesën e datës 25.08.2022 të Zëvendës Kryeinspektorit të Punës për Siguri në Punë, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil [] , me arsyetimin se nga shkresat e lëndës është arritur deri tek përfundimi se nëpunësi civil nuk ka kryer shkelje të detyrave të punës me rastin e adresimit të kërkesës së tij përmes e-mailit të datës 08.05.2022 tek Zëvendës Kryeinspektorit të Punës për



Siguri në Punë, pasi që i njëjti kërkesën e ka adresuar nëpërmjet e-mailit zyrtar tek autoriteti zyrtar për çështjet që kanë ndërlidhje me trajtimin dhe volumin e lëndëve që hyjnë në kuadër të detyrave funksionale të punës në kuadër të Inspektoratit të Punës.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendime ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 48 paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore" si dhe nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "Komisioni vlerëson faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit", dhe në mbështetje të nenit 45 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit njëzëri ka ardhur në përfundimin se është në mandatin dhe kompetencën e Komisioni Disiplinor që mbi bazën e shqyrtimit të fakteve, provave materiale dhe rrethanave objektive të nxjerrë vendim lidhur me inicimin e procedurës disiplinore, dhe jo detyrimisht ndaj secilit rast të inicimit duhet të shqiptojë edhe masën disiplinore, pasi që për një çështje të tillë duhet të përmbushen parakushtet ligjore të përcaktuara me nenin 45 të ligjit material.

Nga se u tha më lartë, nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 10.01.2023 në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë njetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim....", ngase me rastin e konkret, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër:2317 të datës 08.12.2022 Komisioni Disiplinor nuk i ka cënuar të drejtat e ankuesit që burojnë nga marrëdhënia e punës, dhe mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është hedhur poshtë si e palejuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.36/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së